



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:

Institucioni Kombëtar Filarmonia e RMV-së

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë buxhetore themelore (603) për vitin 2020

Qëllimi i revizionit: Të fitohet bindje e arsyeshme se a janë të lira raportet financiare nga materialet e treguara gabimisht.

Gjendjet kyçe të identifikuara:

- lëshime në realizimin e aktiviteteve për punësime të reja dhe akt i pa miratuar për riaudicionin e personave tashmë të punësuar në institucion;
- regjistrimi jo i plotë i kryer i mjeteve me të cilat disponon institucioni dhe pajisjeve të paregjistruara;
- mangësi në dokumentacionin mbështetës gjatë njohjes së bazueshmërisë të disa prej faturave të pranuar për mallra dhe shërbime;
- identifikuan dobësitë të disa nga procedurat e zbatuara të prokurimit publik.

Rekomandimet kyçe:

- përmirësimi i nivelit të transparencës gjatë realizimit të punësimeve të reja dhe zbatimit të procedurës për riaudicim;
- zbatimi i regjistrimit të plotë dhe evidentimi i të gjitha pajisjeve që nuk janë të evidentuar;
- Përmirësimi i nivelit të konkurrencës gjatë realizimit të procedurave të prokurimit publik.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Vërejtjet mbi Draft-Raportin u morën nga drejtori i institucionit dhe drejtorit të mëparshëm.

Mendimi i dhënë*:

Është shprehur mendim i pavoritshëm në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e treguar të rezultateve dhe gjendjes financiare nga aktivitetet financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksionit financiar me rregullativën ligjore relevante, udhëzimeve dhe politikave të vendosura për vitin 2020.

Dobësitë kyçe të sistemit:

- dobësitë në pjesën e financimit të institucioneve nga fusha e kulturës,
- intensifikimi i aktiviteteve për formimin e grupit punues të Ministrisë së Kulturës, Operës dhe Baletit Maqedonas dhe Filarmonisë Maqedonase në bashkëpunim me Radio Televizionin Maqedonas për zbatimin e planë veprimit për zhvillimin e kulturës përmes analizës së nevojshme dhe të disponueshme të kapaciteteve të kuadrit në drejtim të realizimit të plotë të Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Kulturës në Republikën e Maqedonisë
- dobësitë gjatë punësimit të artistëve të kategorisë A në Institucionet Kombëtare që ndikon në realizimin e cilësisë në punë.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra: dy nga vërejtjet u pranuan ndërsa të tjerat paraqesin koment për gjendjen e konstatuar, dhe masat e ndërmarra u pranuan dhe u shfaqën në Raportin Përfundimtar të RASH.

* pozitive, me rezervë, të pavoritshëm, të përmbajtur